



SHBA-ja RITHEKSON THIRRRJEN PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE NË KOSOVË



Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë ritheksuar thirrjen ndaj udhëheqësve politikë të Kosovës që të bashkëpunojnë për formimin e institucioneve, në përputhje me

Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese. ShBA-ja ka vlerësuar se ky ngërç i vazhdueshëm politik po rezulton në mundësi të humbura për Kosovën. "Është koha që udhëheqësit

t'i japin përparësi progresit dhe stabilitetit në të mirë të të gjithë qytetarëve", ka theksuar në një përgjigje për REL-in zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit

VENDIME PËR PRONA DHE EMËRIME: A PO I TEJKALON KOMPETENCAT QEVERIA NË DETYRË? F. 3



PDK-ja DHE ALEANCA PËRSËRI NË SALLËN PLENARE: LV-JA NUK KA TË DREJTË TA MBAJË PENG KUVENDIN, THIRRENI SEANCËN F. 5



AKTUALE



TRUMPI S'E PËRJASHTON MUNDËSINË E RINISJES SË BISEDIMEVE ME IRANIN F. 2

SHQIPËRIA E PARA PËR FONDET NGA BE-ja, KOSOVA, SERBIA DHE BOSNJA 'DJEGIN' PARATË E BRUKSELIT F. 6

VUÇIQI I KËRKON NATO-s TA NDALË TËRHEQJEN E KFOR-it NGA URA NË MITROVICË F. 6

EKONOMI



SEKTORËT E INDUSTRIKË, RITJE NË QARKULLIM DHE PAGA, RËNIE TE NUMRI I TË PUNËSUARVE F. 8

SHIQI ALARMON: QUMËSHI VENDOR PO ZËVENDËSOHET NGA IMPORTI F. 8

SPORT



U. D. PRESIDENTJA HAXHIU NË TARANTO PËR HAPJEN E LOJËRAVE MESHETARE 'TARANTO 2026' F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMPI S'E PËRJASHTON MUNDËSINË E RINISJES SË BISEDIMEVE ME IRANIN



UASHINGTON, 20 GUSHT - Presidenti amerikan Donald Trump tha se negociatat me Iranin mund të rinisin “në një pikë”, por shtoi se është i kënaqur me situatën aktuale. I pyetur nga gazetarët në Shtëpinë e Bardhë lidhur me mundësinë e rinisjes së bisedimeve me Iranin, Trumpi tha se: “Aktualisht, mendoj se situata është e mirë”. Ai shtoi se negociatat mund të rinisin “ndoshta në një pikë”. Presidenti Trump, po ashtu, përsëriti qëndrimin se Irani nuk duhet të ketë armë bërthamore. “Irani nuk mund të ketë armë bërthamore”, tha ai. Sa i përket Ngushticës së

Hormuzit, Trumpi pretendoi se Shtetet e Bashkuara e kanë “nën zotërim, nën kontroll të plotë” këtë rrugë ujore, duke shtuar se aktiviteti i mbetur iranian është një “bezdi”, kur Irani herë pas here rrëzon ndonjë dron. Agjencia e lajmeve “Reuters” citoi kompaninë e inteligjencës tregtare “Kpler”, sipas së cilës gjashtë anije që transportojnë mallra kaluan nëpër ngushticë më 18 gusht, krahasuar me nëntë një ditë më parë dhe nën mesataren ditore prej 11 anijesh gjatë 10 ditëve të fundit. Deklaratat e Trumpit vijnë dy ditë pas skadimit të periudhës 60-ditore të negociatave, të

përcaktuar në bazë të një memorandumit mirëkuptimi mes ShBA-së dhe Iranit, të nënshkruar në qershor. Memorandumi synonte të krijonte një kornizë për përfundimin e konfliktit, parandalimin që Irani të kishte një armë bërthamore dhe rikthimin e lirisë së lundrimit përmes Ngushticës së Hormuzit. Periudha 60-ditore skadoi pa një marrëveshje përfundimtare dhe negociatat janë bllokuar. ShBA-ja thotë se Irani e shkeli memorandumin e qershorit duke sulmuar anije tregtare në ngushticë gjatë korrikut, gjë që nxiti rinisjen e veprimeve ushtarake amerikane.

A ËSHTË “EKSPRESI I KASPIKUT” I PUTINIT NJË LINJË E RE JETIKE MES RUSISË DHE IRANIT?

MOSKË, 20 GUSHT - Deti Kaspik po shfaqet si një korridor potencialisht me rëndësi logjistike në raportet ushtarake që po zgjerohen mes Rusisë dhe Iranit, teksa të dyja vendet kërkojnë të transportojnë mallra aty ku fuqia detare perëndimore nuk ka prani. Ky korridor hap një rrugë që mund t'i mundësojë Moskës dhe Teheranit të shkëmbejnë sasi të mëdha dërgesash përmes një rrugë ujore të mbyllur nga të katër anët me tokë, ku flotat detare perëndimore nuk mund të hyjnë drejtpërdrejt. NBC News raportoi këtë javë se kishte siguruar një dokument, të cilin e konfirmoi me një zyrtar perëndimor, që tregon se Moska tashmë po përdor Detin Kaspik për të dërguar furnizime të lidhura me ushtrinë në Iran. Barry Pavel, ish-drejtor i lartë për politikën dhe strategjinë e mbrojtjes në Këshillin e Sigurisë Kombëtare të ShBA-së, tha se ky korridor meriton më shumë vëmendje, ndërsa dy vendet - të dyja të përfshira në luftëra dhe që janë nën sanksione ndërkombëtare - po thellojnë bashkëpunimin e tyre. “Teksa këto dy vende afrohen me njëra-tjetrën, pritet që të rritet trafiku dhe përdorimi i këtij korridori për të transportuar gjëra në të dyja drejtimet - çfarëdo që Irani po e ndihmon Rusinë dhe anasjelltas”, i tha Pavel Radios Evropa e Lirë. Glen Howard, president i Fondacionit Saratoga, shtoi se Kaspiku është një “lidhje jetike natyrore, e sigurt furnizimi, që funksionon në të dyja drejtimet për rusët dhe iranianët”. Kjo linjë jetike është e mbrojtur, dhe pikërisht për këtë arsye

Rusia dhe Irani e kanë zgjedhur atë. Irani u bë një furnizues i rëndësishëm i Rusisë në luftën e saj në shkallë të plotë kundër Ukrainës, duke i ofruar dronë, teknologji ushtarake dhe pajisje të tjera. Irani gjithashtu e ndihmoi Rusinë t'i zhvillojë kapacitetet për prodhimin e dronëve Shahed, përfshirë në Zonën e Posaçme Ekonomike të Alabugës. Tani Rusia duket se po ia kthen këtë mbështetje, teksa Irani po kërkon t'i rikthejë kapacitetet e shkatërruara gjatë gati gjashtë muajve të konfliktit me Shtetet e Bashkuara dhe Izraelin.

Dërgesa misterioze

Përmbajtja e dërgesave individuale përmes Detit Kaspik është kryesisht e panjohur dhe për këtë arsye është e vështirë të përcaktohet se sa prej këtij trafiku është tregtar, dërgesa të lidhura me ushtrinë apo përbëhet nga lëndë të para. Rruga është gjithashtu një arterie ekonomike, përmes së cilës transportohen drithëra dhe mallra të tjera mes dy vendeve. “Thjesht nuk e dimë se çfarë ka në ngarkesat e atyre anijeve”, tha Howard. “Por, e dimë se ato janë aty. E dimë se trafiku është i madh”. Zyrtarë të lartë të administratës amerikane, të cilët folën në kushte anonimiteti për shkak të ndjeshmërisë së çështjes, i thanë Radios Evropa e Lirë se Uashingtoni po e vëzhgon nga afër raportin më të gjerë ushtarak dhe logjistik mes Rusisë dhe Iranit dhe po monitoron sinjalet se



marrëveshjet e furnizimit gjatë kohës së luftës mund të shndërrohen në infrastrukturë më të qëndrueshme. Zyrtarët nuk pranuan të diskutonin për inteligjencën apo ngarkesa specifike dhe nuk konfirmuan spekulimet për ndihmë të jashtme për operacionet e Ukrainës në Kaspik. Ata paralajmëruan se natyra e mbyllur e Kaspikut dhe transparencja e kufizuar publike e bëjnë të vështirë përcaktimin e përmbajtjes apo qëllimit të dërgesave individuale. Por, ata thanë se çështja po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme për politikanët amerikanë, të cilët po vlerësojnë mënyrën se si Rusia, Irani dhe partnerët e tjerë po ndërtojnë rrjete furnizimi më pak të cenueshme ndaj sanksioneve, presionit detar

dhe formave të tjera të presionit perëndimor. Aspekti gjeografik është kyç. Ndryshe nga i ashtuquajti “Ekspres i Sirisë”, që furnizonte Qeverinë e Bashar al-Assadit përmes rrugëve detare të Mesdheut dhe Bosforit, Kaspiku është një hapësirë ujore e mbyllur nga toka në të gjitha anët. Pajisjet ruse mund të ngarkohen në porte si Olja ose Astrakhan dhe të transportohen përtej Kaspikut, duke e bërë këtë rrugë potencialisht të dobishme për dërgesa të mëdha. Transporti detar mund të ofrojë po ashtu një mënyrë relativisht diskrete për lëvizjen e mallrave. “Mund të dërgosh sasi më të mëdha dhe gjithashtu mund ta bësh këtë në një mënyrë shumë më të heshtur”, tha Howard, duke

shtuar: “Është shumë diskrete dhe e sigurt”. “Marina amerikane nuk mund të hyjë me forcë në Kaspik”, tha ai, duke e përshkruar atë si një “bastion” të mbrojtur rus, ku forcat detare perëndimore nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë. Nga ana tjetër, Kaspiku nuk është plotësisht jashtë rrezes së veprimit të Ukrainës. Fushata e Ukrainës me sulme me rreze të gjatë veprimi kundër caqeve ushtarake dhe ekonomike ruse ka prekur gjithnjë e më shumë infrastrukturën përreth Kaspikut verior, përfshirë në Dagestan. Muajin e kaluar, Kievi goditi një anije tregtare iraniane, duke vlarë një marinar iranian dhe duke shtyrë Teheranin që të kërkojë kompensim dhe të kërcënojë se do të hakmerret.

VENDIME PËR PRONA DHE EMËRIME: A PO I TEJKALON KOMPETENCAT QEVERIA NË DETYRË?



PRISHTINË, 20 GUSHT - Emërimet të bordeve të përkohshme të ndërmarrjeve publike, alokime të mjeteve buxhetore, shpronësime, dhënie me qira të tokës publike, emërimet të komisioneve për pranimin e zyrtarëve në pozita të larta drejtuese dhe emërimet në pozita të larta institucionale. Këto janë disa nga vendimet që i ka marrë Qeveria në detyrë e Kosovës, e udhëhequr nga Lëvizja Vetëvendosje, vetëm pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 7 qershorit. Gjatë kësaj periudhe qeveria në detyrë e Albin Kurtit ka marrë plot 75 vendime në 11 mbledhje qeveritare. Përfaqësues të partive politike dhe të shoqërisë civile vlerësojnë se disa prej vendimeve janë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe me Ligjin për Qeverinë. Sipas tyre, një qeveri në detyrë duhet të kufizohet në aktivitetet e domosdoshme dhe në zbatimin e agjendës së planifikuar më herët.

Vendimet që po kontestohen

Qeveria Kurti - në detyrë që nga shpërbërja e Kuvendit të Kosovës, si rezultat i dështimit të tij në zgjedhjen e presidentit të ri të vendit - ka ndërmarrë procedura për emërimin e individëve në pozita të larta drejtuese edhe pas zgjedhjeve. Ajo ka emëruar një komision të pranimin për pozitën e sekretarit të përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë si dhe në atë të

Ministrisë së Shëndetësisë.

Qeveria në detyrë ka ngritur komisione të ngjashme edhe për poste të tjera, përfshirë atë të drejtorit ekzekutiv për Thesarin e Kosovës. Ajo ka emëruar Ragmi Dalipin drejtor të përgjithshëm të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI).

Përveç emërimeve, qeveria në detyrë ka marrë edhe vendime që prekin pronën publike. Ajo ka vendosur për dhënien me qira të rreth 10 hektarëve tokë në komunën e Hanit të Elezit për 15 vjet, për nxjerrjen dhe shfrytëzimin e gurit gëlqeror. Me kohëzgjatje dhe qëllim të njëjtë, tokë është dhënë me qira edhe në komunën e Ferizajt dhe në atë të Shtimes. Por, për Gzim Shalën, hulumtues në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD), këto vendime bien ndesh me Ligjin për Qeverinë.

Ai tregon për Radion Evropa e Lirë se ligji ndalon iniciimin e procedurave të reja për emërimet në pozita publike dhe marrjen e vendimeve që nuk janë të domosdoshme - siç është dhënia me qira e pronave. “Kjo situatë cenon parimet e sundimit të ligjit, sepse kemi të bëjmë me një situatë të qartë, që është e kundërligjshme dhe është kundërkushtetuese, dhe prapë vazhdon”, shprehet Shala. Liridon Salihi nga Grupi për Studime Politike dhe Juridike (GLPS) thotë për Radion Evropa e Lirë se qeveria në detyrë mund të emërojë kandidatë në pozita publike vetëm nëse procedurat për plotësimin e këtyre pozitave janë iniciuar në kohën kur qeveria ka qenë me mandat të plotë.

Radio Evropa e Lirë kërko

qëndrimin e qeverisë në detyrë lidhur me pretendimet për tejkallim të kompetencave, por nuk mori ndonjë përgjigje deri në publikimin e këtij teksti. Por, pas publikimit të këtij teksti, Tea Blakaj Hoxha, këshilltare ligjore e kryeministrit në detyrë Kurti, shkroi në rrjetet sociale se Ligji për Qeverinë, ndonëse vendos kufij në veprimin e qeverisë, nuk e bën ekzekutivin një “organ nominal, pa funksion dhe pa përgjegjësi”. “Kufizimi i kompetencave nuk është pezullim i ekzekutivit”, shkroi ajo, duke shtuar se ligji nuk ndalon shprehimisht çështjet që janë në domenin e qeverisë. “Shteti nuk vihet në pritje për shkak të tranzicionit politik”, tha këshilltarja e Kurtit.

Çfarë thotë Ligji për Qeverinë?

Ligji për Qeverinë përcakton se një qeveri në detyrë ka kompetenca të kufizuara që nuk mund t'i tejkalojë. Në mënyrë të qartë ndalohet marrja e vendimeve të rëndësishme. Sipas këtij ligji, një qeveri në detyrë mund t'i zbatojë vetëm aktivitetet e domosdoshme, të planifikuara në planin vjetor dhe në Ligjin për Buxhetin. Asaj nuk i lejohet të miratojë iniciativa për nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që kërkojnë ratifikim nga Kuvendi, e as të miratojë projektligje, ndryshime kushtetuese, strategji apo dokumente konceptuale. Ligji thotë, po ashtu, se një qeveri në detyrë nuk mund të nisë procedura të reja për emërimet

në funksione publike, e as të propozojë kandidatë për pozita që kërkojnë miratimin e Kuvendit.

Për Shalën e Salihin, situata është bërë edhe më komplekse pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, teksa disa anëtarë të kabinetit qeveritar në detyrë janë zgjedhur deputetë të Kuvendit të Kosovës. Sipas tyre, të gjitha vendimet e anëtarëve të qeverisë, të cilët janë njëkohësisht edhe deputetë, janë vendime të kundërligjshme.

Ligji për Qeverinë parasheh që nëse një anëtar i kabinetit qeveritar zgjidhet deputet, ai duhet të japë dorëheqje nga posti i ministrit para ditës së certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) certifikoi më 8 korrik rezultatet e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Edhe neni 72 i Kushtetutës së Kosovës thotë se “deputeti i Kuvendit të Kosovës nuk mund të mbajë ndonjë post ekzekutiv në administratën publike ose në ndonjë ndërmarrje në pronësi publike, dhe as të ushtrojë ndonjë funksion tjetër ekzekutiv”.

Kontestimi i vendimeve shkon në Prokurori

Shala nga IKD kujton edhe një vendim të vitit të kaluar të Gjykatës Supreme, në të cilin është konstatuar se ushtrimi i njëkohshëm i këtyre dy funksioneve është në kundërshtim me Kushtetutën. Gjykata konstatoi se një qeveri në detyrë mund të kryejë vetëm

aktivitete të domosdoshme dhe ato të planifikuara, dhe se nuk ka të drejtë të miratojë akte të reja nënligjore. “Qytetarët duhet ta kuptojnë qartë se personat që ligji nuk i lejon të veprojnë si anëtarë të qeverisë, po marrin vendime në emër të shtetit dhe po krijojnë detyrime që mund të rëndojnë institucionet për shumë vite”, thotë Shala për Radion Evropa e Lirë.

Salihi nga GLPS thotë se të gjitha vendimet që kanë tejkalluar kufizimet e Qeverisë në detyrë ose ato vendime që janë marrë nga përbërja e kundërligjshme, ku anëtarët e Qeverisë njëkohësisht kanë mbajtur edhe pozitën e deputetit, duhet të rishikohen dhe të anulohen. “GLPS vlerëson që çfarëdo veprimi që i pason këto vendime është i kontestueshëm, pasi përbërja e organit kolegial që i ka nxjerrë të njëjtat ka qenë në papajtueshmëri me legjislacionin në fuqi”, pohon ai për Radion Evropa e Lirë.

Debatimi për ligjshmërinë e veprimeve të qeverisë në detyrë u nxit pas një mbledhjeje që ajo e mbajti më 12 gusht.

Aleanca, parti parlamentare, paralajmëroi se do të paraqesë rast në prokurori për 18 vendime të qeverisë në detyrë. Këto vendime lidhen, kryesisht, me emërimin e komisioneve për procedurat e pranimin në institucione publike.

Besnik Tahiri, deputet i Aleancës në Kuvendin e Kosovës, tha për media se konsideron që këto vendime janë marrë në kundërshtim me ligjin dhe se qeveria në detyrë po e përdor administratën për interesa partiake.

SHBA-ja RITHEKSON THIRRJEN PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE NË KOSOVË

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë ritheksuar thirrjen ndaj udhëheqësve politikë të Kosovës që të bashkëpunojnë për formimin e institucioneve, në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese. ShBA-ja ka vlerësuar se ky ngërç i vazhdueshëm politik po rezulton në mundësi të humbura për Kosovën. “Është koha që udhëheqësit t’i japin përparësi progresit dhe stabilitetit në të mirë të të gjithë qytetarëve”, ka theksuar në një përgjigje për REL-in zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 20 GUSHT - Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë ritheksuar thirrjen ndaj udhëheqësve politikë të Kosovës që të bashkëpunojnë për formimin e institucioneve në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

Në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë, një zëdhënës i Departamentit Amerikan të Shtetit tha se udhëheqësit politikë duhet të punojnë së bashku për tejkalimin e ngërçit institucional. “Ky ngërç i vazhdueshëm politik po rezulton në mundësi të humbura për Kosovën. Është koha që udhëheqësit t’i japin përparësi progresit dhe stabilitetit në të mirë të të gjithë qytetarëve”, tha zëdhënësi.

Kjo është thirrja e dytë e ngjashme e bërë nga pala amerikane brenda pak kohësh, pasi kërkesë të ngjashme për bashkëpunim kishte shprehur edhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë më 12 gusht.

Thirrja e re amerikane vjen në kohën kur Kuvendi i Kosovës ende nuk është konstituuar pas zgjedhjeve të 7 qershorit. Seanca konstituive e legjislaturës së re nisi më 6 gusht. Deputetët bënë betimin, por procesi nuk kaloi në fazën e zgjedhjes së kryetarit të Kuvendit.

Albin Kurti, në cilësinë e kreut të Lëvizjes Vetëvendosje, kërkoi kohë shtesë për konsultime me partitë, duke thënë se ende nuk kishte marrëveshje për formimin e institucioneve. Seanca u ndërpre dhe u caktua të vazhdonte më 8 gusht.

Edhe në vazhdimin e 8 gushtit nuk pati kandidaturë për kryetar të Kuvendit. Kurti kërkoi sërish kohë shtesë për konsultime me partitë, por pas kësaj deputetja e Aleancës, Time Kadrijaj, hodhi vezë në drejtim të tij. Pas këtij incidenti kryesuesi i seancës, Avni Dehari, ndërpreu punimet.

Që atëherë, procesi ka mbetur i bllokuar. Dehari ka thënë se seanca e radhës do të thirret kur partitë të arrijnë një marrëveshje për zgjidhjen e krizës, duke argumentuar se pa një marrëveshje politike nuk ka kuptim që seanca të mbahet

vetëm si formalitet.

Ndërkohë, në përpjekje për të gjetur një zgjidhje politike, më 18 gusht Kurti u takua me kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhiku, me fokus te zgjedhja e presidentit të ardhshëm. Pas takimit, të dy thanë se kishte vullnet për të gjetur një zgjidhje, ndërsa u pajtuan që në takimin e radhës të shqyrtojnë emra konkretë për president.

PDK-ja dhe Aleanca, në anën tjetër, kanë kërkuar që seanca të vazhdojë pa pritur një marrëveshje politike. Më 12 gusht deputetë të këtyre dy partive u mblodhën në sallën e Kuvendit duke kërkuar nga Dehari që ta thërrasë vazhdimin e seancës, ndërsa pati edhe përplasje me deputetë të LV-së. Përveç ShBA-së, edhe Bashkimi Evropian u ka bërë më herët thirrje partive politike që të

gjejnë sa më shpejt një zgjidhje për krizën institucionale. BE-ja ka paralajmëruar se ngërçi politik dhe vonesat në zbatimin e reformave mund ta kufizojnë aftësinë e Kosovës për të përfutur nga mbështetja evropiane.

Në kuadër të Planit të Rritjes, Kosovës i janë vënë në dispozicion 882.6 milionë euro në grante dhe kredi të favorshme deri në fund të vitit 2027, ndërsa pagesat lidhen me përmbyshjen e hapave të përcaktuar në Agjendën e Reformave.

Komisioni Evropian ka përcaktuar 111 hapa reformues për Kosovën. Për 13 prej tyre, me vlerë të përbashkët prej 90.8 milionë eurosh, afati i parë përmbyshës ishte 30 qershori 2026, ndërsa 27 hapa të tjerë, me vlerë prej 165.9 milionë eurosh, kanë afat deri në fund të

dhjetorit.

Edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar ka vlerësuar se ngërçi i zgjatur politik ka kufizuar përparimin e Kosovës në zbatimin e agjendës së reformave të Planit të Rritjes dhe qasjen në financime të jashtme.

PDK-ja dhe Aleanca përsëri në sallën plenare: LV-ja nuk ka të drejtë ta mbajë peng Kuvendin, thirrreni seancën

Deputetët e grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës edhe të enjten në orën 11:00 kanë qenë të pranishëm në sallën plenare të Kuvendit të Kosovës ku do të duhej të mbahej vazhdimi i seancës konstituive.



VUÇIQI I KËRKON NATO-s TA NDALË TËRHEQJEN E KFOR-it NGA URA NË MITROVICË

PRISHTINË, 20 GUSHT - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha se i ka kërkuar sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, që KFOR-i, misioni i aleancës në Kosovë, ta ndalë zvogëlimin gradual të pranisë në urën kryesore mbi lumin Ibër në Mitrovicë të Veriut. “Sapo i dërgova një letër sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, dhe kërkoja që KFOR-i, në përputhje me Rezolutën 1244 të OKB-së, ta ndalë terrorin ndaj serbëve, përndjekjen dhe arrestimet e tyre, rrënimin e shtëpive, si dhe hapjen e urës mbi Ibër”, shkroi Vuçiq në “Instagram” më 20 gusht. “Besoj se vlerësimi i tij do të jetë se paqja dhe stabiliteti rajonal janë të një rëndësie të madhe”, shtoi ai. Radio Evropa e Lirë i është drejtuar NATO-s për koment lidhur me kërkesën e Vuçiqit dhe është në pritje të përgjigjes.

Mitrovica, pas luftës së vitit 1999, u nda në pjesën veriore, me shumicë serbe, dhe atë jugore, ku shumicën e përbëjnë shqiptarët. Sot ato funksionojnë si dy komuna të ndara. Megjithatë, që nga përfundimi i luftës KFOR-i e ka mbajtur nën mbikëqyrje urën mbi Ibër, e cila ndër vite ka qenë pikë e përplasjeve ndëretnike. Sipas Vuçiqit, tërheqja e KFOR-it nga ura në këtë kohë do të “krijonte kushte për një përballje përfundimtare me popullsinë serbe” në veri të Kosovës. Ai tha se autoritetet në Serbi do ta vazhdojnë “luftën politike me të gjitha mjetet e mundshme”, duke mos përjashtuar as mundësinë e thirrjes së një seance të posaçme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Vuçiqi tha se shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Serbisë, Millan Mojsilović, ka



zhvilluar një bisedë “shumë të vështirë” dhe “të keqe” me komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Ozkan Ulutash. Ulutash u takua më 12 gusht edhe me përfaqësues të Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve të Kosovës që gëzon mbështetjen e Beogradit dhe që gjithashtu kundërshton zvogëlimin e pranisë së KFOR-it në urën mbi Ibër. Komandanti i KFOR-it tha

atëherë se procesi i optimizimit të pranisë ishte nisur si rezultat i përmirësimit të situatës së sigurisë në Kosovë dhe se ai do të zhvillohej gradualisht. Ura kryesore mbi lumin Ibër konsiderohet një nga pikat më të ndjeshme në aspektin e sigurisë në veri të Kosovës. Misioni i NATO-s ka theksuar se vazhdon ta zbatojë mandatin e tij në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të

Kombeve të Bashkuara, duke kontribuar në ruajtjen e një mjedisi të sigurt dhe të lirisë së lëvizjes për të gjithë njerëzit në Kosovë. KFOR-i ka thënë se do të vazhdojë të veprojë në mënyrë të paanshme dhe në koordinim me Policinë e Kosovës dhe EULEX-in në përputhje me rolet përkatëse të secilit në fushën e sigurisë. Ura kryesore mbi Ibër aktualisht është e hapur vetëm për këmbësorë. Qeveria e Kosovës kishte paralajmëruar në korrik të vitit 2024 hapjen e saj edhe për qarkullimin e automjeteve, një nismë që shkaktoi tensione dhe reagime nga bashkësia ndërkombëtare. Ndërkohë, Qeveria e Kosovës ka ndërtuar edhe dy ura të tjera pranë urës kryesore - një për këmbësorë dhe një për automjete - me synimin për ta lidhur Mitrovicën e Veriut me Mitrovicën e Jugut.



Deputeti i PDK-së, Jakup Nura, nga foltorja e Kuvendit të Kosovës i ka bërë thirrje kryesuesit të seancës sipas moshës, Avni Deharit, që ta kryejë detyrën e tij, ta thërrasë seancën në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit. “Një funksion teknik nuk mund të shndërrohet në armë politike. Kur një pozitë përdoret për ta bllokuar procedurën, nuk kemi më një problem procedural, por një problem institucional”, theksoi Nura. Ai tha se Lëvizja Vetëvendosje, ndonëse i ka fituar zgjedhjet, nuk ka të drejtë t’i marrë peng institucionet. “Sot nuk po flasim për një parti politike, po flasim për Kosovën. Qytetarët votuan. Vullneti i tyre është shprehur. Tani ai duhet të respektohet dhe institucionet duhet të ndërtohen. Partia që ka fituar zgjedhjet nuk ka të drejtë ta

mbajë peng Kuvendin. Fitorja në zgjedhje është mandat për të qeverisur, jo licencë për ta bllokuar shtetin”, shtoi ai. PDK-ja do t’i drejtohet përsëri kryesuesit të seancës për nga moshja, Avni Dehari, me kërkesën për vazhdimin e seancës konstituive pas 48 orësh. Edhe deputetja e Aleancës, Albana Bytyqi, nga foltorja e Kuvendit ka kërkuar formimin e institucioneve të Kosovës, duke thënë se vendi përballet me probleme dhe sfida që kërkojnë zgjidhje urgjente. Bytyqi ka deklaruar se si përfaqësues të popullit nuk mund të qëndrojnë të heshtur përballë problemeve me të cilat po përballet Kosova. “Si përfaqësues të popullit nuk mund të qëndrojmë të heshtur, sepse Kosova ka probleme e sfida të cilat kërkojnë zgjidhje. Para vetes janë shumë tema të cilat duhet të zgjidhen me urgjencë

nga spektri politik. Të gjithë e dimë se institucionet janë të nevojshme të formohen, sepse nafta në vendin tonë është 1.78 euro”, tha Bytyqi. Ajo ka renditur disa nga çështjet që, sipas saj, kërkojnë funksionalizimin e Kuvendit dhe institucioneve.

PDK-ja dhe Aleanca paralajmërojnë protesta nëse vazhdon bllokimi për formimin e institucioneve

Deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës kanë vazhduar për të gjashtën ditë radhazi aksionin e tyre, duke bllokuar hyrjen e Qeverisë së Kosovës në shenjë proteste ndaj mosvazhdimin të seancës konstituive të Kuvendit. Aksionit të PDK-së këtë të enjte iu bashkuan edhe deputetët të Aleancës si dhe drejtues e

asamblistë të PDK-së nga komuna e Vushtrrisë. Ata kërkuar kthimin e procesit në Kuvend dhe konstituimin e institucioneve. Asamblistja e PDK-së në Vushtri, Vlera Tahiri, tha se qytetarët e kësaj komune kanë nevojë për investime dhe projekte zhvillimore, ndërsa për këtë nevojiten institucione funksionale. “Vushtrria ka nevojë për investime, projekte zhvillimore dhe një qeveri që i trajton komunat dhe qytetarët me përgjegjësi. Për këtë na duhen institucione që punojnë dhe një Kuvend funksional, ku këto çështje ngrihen, diskutohen dhe kërkohet llogaridhënie. Procesi duhet të kthehet në Kuvend, seanca duhet të vazhdojë dhe institucionet duhet të konstituohen”, tha Tahiri. Deputetja e PDK-së, Ganimete Musliu, tha se aksionet do të vazhdojnë deri në realizimin e

kërkesës së tyre për, siç u shpreh, “kthimin e kushtetutshmërisë, ligjshmërisë dhe legjitimitetit të shtetit”. “Jemi këtu për të gjashtën ditë radhazi për t’i kërkuar Albin Kurtit që të reflektojë, të kthehet në Kuvend dhe t’i konstituojë institucionet e vendit, për çka ka marrë mandatin dhe besimin e qytetarëve. Nuk do të ndalemi deri në realizimin e kërkesës sonë”, tha Musliu. Ndërsa deputetja e Aleancës, Time Kadrijaj, kërkoi respektimin e Kushtetutës dhe të vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me afatet për konstituimin e Kuvendit. “Askush nuk është mbi ligjin, as Albin Kurti. Ne nuk do të ndalemi së organizuari deri në konstituimin e plotë të Kuvendit dhe formimin e institucioneve. Nëse Albin Kurti vazhdon me këtë avaz, edhe ne do të vazhdojmë me protesta, të cilat do të jenë edhe më masive”, tha Kadrijaj.

Zgjatet afati për aplikim në Provimin e Maturës Shtetërore deri më 24 gusht

PRISHTINË, 20 GUSHT - Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka njoftuar se është zgatur afati për aplikim në Provimin e Maturës Shtetërore me qëllim që të gjithë nxënësit që kanë të

drejtë t'i nënshtrohen këtij provimi të kenë mundësi të aplikojnë. Sipas njoftimit, afati i aplikimit është zgatur deri të hënën, më 24 gusht 2026, në orën 11:00,

ndërsa aprovimi i aplikimeve do të bëhet po të njëjtën ditë deri në orën 12:00. Deri më tani për Provimin e Maturës Shtetërore kanë aplikuar 4 650 nxënës.

Megjithatë, bazuar në rezultatet e afatit të qershorit, Ministria vlerëson se rreth 1 000 nxënës, të cilët kanë të drejtë t'i nënshtrohen provimit, ende nuk kanë aplikuar.



SHQIPËRIA E PARA PËR FONDET NGA BE-ja, KOSOVA, SERBIA DHE BOSNJA ‘DJEGIN’ PARATË E BRUKSELIT



PRISHTINË, 20 GUSHT - Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor synojnë integrimin në Bashkimin Evropian (BE), por miliardat e eurove të ofruara përmes Planit të Rritjes kanë nxjerrë në pah dallimet mes tyre. Nga gjashtë vendet aspirante për anëtarësim në BE, vetëm tri kanë arritur të përfitojnë në mënyrë të konsiderueshme nga fondet në bazë të përmbushjes së reformave. Sipas një analize të publikuar nga “Euractiv”, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut janë vendet që kanë avancuar më shumë në shfrytëzimin e këtij mekanizmi, ndërsa Kosova, Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina janë penguar nga krizat politike dhe problemet me reformat. Shqipëria kryeson rajonin për fondet e përfituara. Deri në maj të vitit 2026, ajo ka marrë rreth 212 milionë euro, duke u

vlerësuar si një prej vendeve që ka arritur të përmbushë më mirë kërkesat e Planit të Rritjes. Edhe pse politika shqiptare mbetet e polarizuar, shumica e qëndrueshme qeverisëse i ka mundur vendit të avancojë me reformat e kërkuara nga Brukseli. Mali i Zi, i cili konsiderohet pretendenti më i avancuar për anëtarësim në BE, ka përfutur rreth 91 milionë euro. Vendi vlerësohet për kompromiset e arritura në skenën e brendshme politike, megjithëse mbetet shqetësues hendeku mes progresit të deklaruar dhe atij që mund të verifikohet nga institucionet evropiane, veçanërisht në drejtësi dhe sundimin e ligjit. Ndërkohë, Maqedonia e Veriut ka përfutur rreth 141 milionë euro. Megjithatë, ngërçi politik rreth ndryshimeve kushtetuese dhe procesit të integritimit evropian vazhdon të paraqesë

pengesë për avancimin e mëtejshëm të vendit drejt BE-së. Në anën tjetër, Kosova është një prej shembujve më të theksuar të pasojave që mund të ketë kriza politike në përfitimin e fondeve evropiane. Kriza e gjatë politike, zgjedhjet e njëpasnjëshme, mungesa e konsensusit dhe vështirësitë në krijimin e institucioneve funksionale kanë ndikuar drejtpërdrejt në aftësinë e Kosovës për të përmbushur kushtet e kërkuara nga Bashkimi Evropian. Deri në maj të vitit 2026, Kosova ka përfutur vetëm 61 milionë euro, ndërsa BE-ja ka paralajmëruar se vazhdimi i krizës mund të rrezikojë fondet e tjera të parapara për vendin. Situatë të vështirë ka edhe Bosnja e Hercegovina, e cila nuk ka arritur të realizojë reformat e kërkuara dhe, për

këtë arsye, nuk ka përfutur asnjë euro nga Plani i Rritjes. Ndërsa Serbia, pavarësisht se ka një shumicë të qëndrueshme parlamentare, është përballur me kritika të vazhdueshme nga BE-ja për reformat në drejtësi dhe çështjet që lidhen me sundimin e ligjit. Deri në maj të vitit 2026, Serbia kishte përfutur rreth 168 milionë euro, duke u renditur e dyta pas Shqipërisë, por fondet e saj janë pezulluar për shkak të mospërputhjeve me kërkesat e Brukselit. Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor ka një vlerë totale prej 6 miliardë eurosh dhe është paraparë të zbatohet deri në dhjetor të vitit 2027. Përfitimi nga këto fonde është i lidhur drejtpërdrejt me zbatimin e reformave dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara nga BE-ja. Megjithatë, edhe vendet që kanë avancuar më shumë ende

nuk i kanë shfrytëzuar plotësisht fondet në dispozicion. Shqipëria, e cila kryeson rajonin, ka përfutur rreth 23 për qind të shumës së paraparë prej rreth 922 milionë eurosh, ndërsa Kosova ka arritur të përfitojë vetëm rreth 7 për qind të fondeve të saj. Koha po ngushtohet për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Me përfundimin e Planit të Rritjes në dhjetor 2027, vendet që mbeten të bllokuara nga krizat politike dhe që nuk arrijnë të zbatojnë reformat rrezikojnë të humbin përfundimisht një pjesë të rëndësishme të financimit evropian. Në këtë garë, Shqipëria aktualisht është në krye, ndërsa Kosova përballlet me presionin që të kapërcejë sa më shpejt ngërçin politik dhe të krijojë kushtet për të përfutur nga fondet që i janë vënë në dispozicion. (Abcnews.al)

Skenderaj freskon rrugët me ujë për shkak të temperaturave të larta

SKENDERAJ, 20 GUSHT - Për t’iu bërë ballë temperaturave të larta, në Skenderaj ka nisur freskimi i rrugëve të qytetit me ujë.

Kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku, ka bërë me dije se kjo masë po ndërmerret për të sjellë sadopak freski dhe lehtësim për qytetarët

gjatë ditëve të nxehta. “Për t’iu dalë përballë temperaturave të larta, po freskohen rrugët e qytetit me ujë, duke sjellë sado

pak freski dhe lehtësim për qytetarët gjatë këtyre ditëve të nxehta!”, ka shkruar Lushtaku në “Facebook”.



Digjitalizohen shkollat e komunës së Rahovecit

RAHOVEC, 20 GUSHT - Në kuadër të projektit për digjitalizimin e shkollave, Drejtoria Komunale e Arsimit ka filluar vendosjen e tabelave digjitale në institucionet arsimore të komunës sonë. Tashmë ka përfunduar

vendosja e 14 tabelave digjitale, ndërsa deri në përfundim të projektit planifikohet të vendosen gjithsej 135 tabela digjitale në shkollat e Komunës së Rahovecit. Komuna e Rahovecit ka

njoftuar se ky projekt synon ta avancojë procesin mësimor, të mundësojë mësimdhënie më cilësore dhe më bashkëkohore si dhe të krijojë mundësi të reja për zhvillimin e kompetencave dhe shkathtësive të nxënësve.



KOSOVË - IZMIR, DREJT BASHKËPUNIMIT MË TË FUQISHËM EKONOMIK



EPOKA E RE Qendresa RAMA

Prishtinë, 20 gusht - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, priti në takim kryetarin e qytetit të Izmirit, Cemil Tugay, me të cilin diskutoi për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Kosovës dhe këtij metropoli turk me rreth 4.5 milionë banorë. Në takim u veçua interesi i kompanive nga Izmiri për të bashkëpunuar me bizneset e

Kosovës, veçanërisht në prodhim, industrinë e çelikut, tekstil dhe makineri bujqësore. Në kuadër të këtij bashkëpunimi pritet të organizohet një mision ekonomik i bizneseve nga Izmiri në Kosovë, me takime B2B, vizita në kompani prodhuese dhe prezantim të mundësive konkrete për tregti, investime dhe partneritete të reja. OEK-u ka theksuar se mbetet e përkushtuar për krijimin e urave të reja të bashkëpunimit

dhe për promovimin e Kosovës si destinacion për investime dhe partneritete ndërkombëtare. Edhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka pritur në takim kryetarin e qytetit të Izmirit, Cemil Tugay. “Dy vjet pas takimit miqësor në zyrën e tij, sot pata kënaqësinë të mirëpresë në Kryeministrinë e Republikës së Kosovës kryetarin e Bashkisë Metropolitane të Izmirit, Dr. Cemil Tugay, me bashkëpunëtorë. Përveçse

marrëdhënie të shkëlqyeshme me Turqinë, vendi ynë ka lidhje të veçantë me këtë qytet që u bë shtëpi për shumë shqiptarë të dëbuar nga dhuna dhe terrori i Serbisë e Jugosllavisë përgjatë shekullit të kaluar. Ndonëse asnjëherë nuk e harrojnë prejardhjen e tyre, bashkatdhetarët tanë atje janë pjesë e pandarë dhe çmuar e shoqërisë në Izmir”, ka shkruar Kurti në “Facebook”. Ai ka theksuar se me kryetarin Tugay biseduan për mundësitë

konkrete të thellimit dhe zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet Izmirit dhe Kosovës në ekonomi, industri e ndërmarrësi, arsim e kulturë, teknologji e inovacion, sikurse edhe në bujqësi, mjedis e energji. “Krahas potencialit për investime dhe tregti, folëm për rëndësinë dhe mundësitë e shkëmbimit të përvojave në një sërë fushash, e veçmas në atë të shëndetësisë, mjedisit dhe të menaxhimit të mbeturinave”, ka deklaruar Kurti.

RIFILLOJNË PUNIMET PËR ZGJERIMIN E RRUGËS LËBUSHË - STRELLC NË KATËR KORSI

DEÇAN, 20 GUSHT - Kanë rifilluar punimet në segmentin rrugor Lëbushë - Strellc, në kuadër të projektit për zgjerimin e rrugës në katër korsi. Kryetari i Deçanit, Bashkim

Ramosaj, ka bërë me dije se punimet në këtë segment janë rikthyer, duke e cilësuar projektin ndër investimet e rëndësishme infrastrukturore për komunën. Sipas Ramosajt, zgjerimi i rrugës

pritet të ndikojë në rritjen e sigurisë në komunikacion, lehtësimin e qarkullimit dhe përmirësimin e lidhjes ndërmjet fshatrave. “Punët po vazhdojnë”, ka shkruar Ramosaj.



QKUK: 320 pacientë morën shërbime emergjente gjatë 24 orëve të fundit



PRISHTINË, 20 GUSHT - Gjatë 24 orëve të fundit ekipet e Qendrës Emergjente të QKUK-së kanë ofruar gjithsej 320 shërbime emergjente për qytetarët. Sipas dhënave të QKUK-së, pacientët janë trajtuar në njësitë përkatëse emergjente, ku 74 pacientë janë trajtuar në Reanimim, 102 në Emergjencën Internistike, 52 në

Emergjencën Kirurgjike dhe 56 në Emergjencën Ortopedike. Ndërkaq, në Sallën e Vogël janë trajtuar 16 pacientë, të cilëve u janë ofruar shërbime për qepje, përpunim dhe pastrim të plagëve. Në mesin e rasteve të trajtuara janë evidentuar edhe 20 persona të lënduar si pasojë e aksidenteve

në trafik. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 38 pranime për trajtim në klinika të ndryshme të QKUK-së. QKUK ka bërë me dije se ekipet shëndetësore kanë qenë të angazhuara vazhdimisht për t'u ofruar pacientëve kujdesin e nevojshëm emergjent.

ShIQK alarmon: Qumështi vendor po zëvendësohet nga importi

PRISHTINË, 20 GUSHT - Shoqata e Industrisë së Qumështit e Kosovës (SHIQK) ka ngritur shqetësimin për gjendjen e sektorit vendor të qumështit, duke paralajmëruar se rritja e importeve dhe konkurrenca e çmimeve mund t'i dëmtojnë seriozisht fermerët dhe përpunuesit e Kosovës. Në një njoftim publik, ShIQK thekson se sektori i qumështit është ndërtuar ndër vite

përmes investimeve private, subvencioneve publike dhe punës së mijëra fermerëve e përpunuesve. “Pikërisht në momentin kur ky sektor kishte arritur një nivel ku mund të konkurronte më seriozisht me importin, u përballëm me një valë dezinformatash, interpretime të paqarta dhe masa që goditën rëndë prodhuesin vendor”, thuhet në reagimin e shoqatës.

Sipas ShIQK-së, ndikimi i kësaj situatë është duke u reflektuar edhe në treg, ku produktet vendore po humbin hapësirë përballë produkteve të importuara. “Rezultati sot shihet qartë në raftet e marketeve: produktet e Kosovës zvogëlohen, ndërsa hapësira e tyre po zëvendësohet gjithnjë e më shumë nga importi”, thuhet në njoftim. Shoqata e Industrisë së

Qumështit e konsideron veçanërisht shqetësues faktin se një litër qumësht i importuar mund të shitet me pakicë për 0.49 euro, ndërsa prodhuesit vendorë përballen me kosto të grumbullimit dhe përpunimit të qumështit të freskët. “Po bëhet më lirë ta blesh qumështin e gatshëm në supermarket sesa ta grumbullosh nga fermeri vendor”, paralajmëron ShIQK.



Sipas saj, situata nuk paraqet vetëm problem të konkurrencës mes kompanive, por prek drejtpërdrejt fermerët, industrinë përpunuese, vendet e punës dhe sigurinë ushqimore të vendit.

ECO PARKU INDUSTRIAL NË GJAKOVË, MINTI DËGJON KËRKESAT E BIZNESEVE PËR ZHVILLIMIN E PARKUT TË RI

GJAKOVË, 20 GUSHT - Pas miratimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës, më 22 maj 2026, të shqyrtimit paraprak për shpronësimin e ndërmarrjeve shoqërore “Metaliku” dhe “Virxhinia”, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit ka ndërmarrë hapin e radhës, duke zhvilluar konsultime me bizneset e Gjakovës për ndërtimin e Eco Parkut të ri Industrial. Mbi 50 biznese morën pjesë në takimin e zhvilluar në Gjakovë, ku u diskutua për planin e investimit që MINTI synon ta realizojë në hapësirat e “Metalikut” dhe “Virxhinias”, ndërsa vëmendje e veçantë iu kushtua dëgjimit të kërkesave dhe nevojave të bizneseve. Gjatë takimit bizneset paraqitën kërkesat e tyre kryesisht në lidhje me infrastrukturën, energjinë, hapësirat e përbashkëta dhe kushtet e punës brenda parkut. Qëllimi është që Eco Parku Industrial në Gjakovë

të ndërtohet si një hapësirë moderne, efikase dhe e qëndrueshme, në harmoni të plotë me mbrojtjen e mjedisit dhe me kushte që u ofrojnë bizneseve siguri dhe mundësi për zhvillim afatgjatë. Sipas planit të paraparë, hapësirat e “Metalikut” do të fokusohen kryesisht në sektorin e metalit, industrinë e ndërtimit dhe industri të ngjashme, ndërsa hapësirat e “Virxhinias” do të orientohen në industrinë e plastikës, paketimit ushqimor dhe industri të tjera më të lehta. Ky kombinim synon të krijojë një strukturë të përshtatshme të veprimtarive prodhuese brenda parkut. Eco Parku Industrial do të konceptohet me qendër të përbashkët për shërbime biznesi, energji eficiente, panele solare me hapësirë për bateri, si dhe impiant për trajtimin e ujërave të zeza. Hapësirat ekzistuese do të transformohen dhe modernizohen në përputhje me nevojat



e bizneseve dhe standardet bashkëkohore për zhvillimin e parqeve industriale. Në vjeshtë pritet të nisë studimi i fizibilitetit, ndërsa synimi është që, pas përfundimit të planifikimit dhe marrëveshjes me IFC-në, gjatë vitit të ardhshëm të fillojë ndërtimi i Eco Parkut Industrial në Gjakovë.

Një nga ndryshimet e rëndësishme që pritet të sjellë funksionalizimi i parkut lidhet edhe me sigurinë dhe perspektivën afatgjatë të bizneseve rezidente. Përmes këtij projekti bizneset do të kenë mundësi t'i shfrytëzojnë hapësirat për periudha afatgjata, duke krijuar kushte më të qëndrueshme për zhvillimin e aktivitetit të tyre, në

vend të funksionimit përmes kontratave njëvjeçare. Gjatë qëndrimit në Gjakovë, ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, vizitoi edhe nga afër hapësirat e ndërmarrjeve “Virxhinia” dhe “Metaliku”, ku u njoh me gjendjen aktuale të infrastrukturës. Transformimi i këtyre hapësirave nga infrastruktura ekzistuese në një park industrial modern synon të krijojë ambiente më të përshtatshme për zhvillimin e bizneseve dhe veprimtarive prodhuese. MINTI synon që në bashkëpunim me bizneset e Gjakovës, bizneset e tjera vendore dhe investorët e huaj, ta zhvillojë këtë projekt si një investim që do të kontribuojë në rritjen e ekonomisë lokale, krijimin e vendeve të reja të punës dhe krijimin e kushteve moderne për bizneset që do të operojnë në këto hapësira.

SEKTORËT E INDUSTRISË, RITJE NË QARKULLIM DHE PAGA, RËNIE TË NUMRI I TË PUNËSUARVE



PRISHTINË, 20 GUSHT - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën afatshkurtra të industrisë për muajin qershor 2026. Në muajin qershor të vitit 2026 sektorët e industrisë kishin rritje për 5,86 % krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (qershor 2025). Sipas aktivitetit ekonomik, rritje kishte tek industria nxjerrëse (minierat dhe guroret) me 48,21 %; furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave me 15,85 %; furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar me 9,31 %; si dhe në sektorin e

industrisë përpunuese për 3,17 %. Indeksi i numrit të të punësuarve: Në muajin qershor të vitit 2026 sektorët e industrisë kishin rënie për (-1.22 %) krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (qershor 2025). Sipas aktivitetit ekonomik, rritje kishte te: furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar me 6,62 % dhe furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave me 2,04 %. Ndërsa rënie kishte në sektorin e industrisë përpunuese për (-2,26 %) dhe te industria

nxjerrëse (minierat dhe guroret) për (-12,55 %). Indeksi i fondit të pagave dhe mëditjeve: Në muajin qershor të vitit 2026 sektorët e industrisë kishin rritje për 10,27 % krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (qershor 2025). Sipas aktivitetit ekonomik, rritje kishte te: furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar me 14,88 %; furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave me 12,74 %; industria përpunuese me 9,14 %; si dhe tek industria nxjerrëse (minierat dhe guroret) me 2,46 %.

Një hap tjetër drejt financimit për investime të gjelbra në Kosovë

PRISHTINË, 20 GUSHT - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) dhe ProCredit Bank Kosova kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për zbatimin e instrumentit “Depozita e Gjelbër”. Përmes këtij

instrumenti, FKGK, duke plasuar depozita në institucionet financiare partnere, kontribuon në orientimin e financimit drejt investimeve të gjelbra për bizneset. Bashkëpunimi përmes Depozitës

së Gjelbër me ProCredit Bank krijon më shumë mundësi për mbështetjen e investimeve më efikase, më të qëndrueshme dhe me ndikim pozitiv. Kjo iniciativë është e mbështetur nga projekti “Transformimi i Gjelbër i

Ndërmarrjeve Private në Kosovë” (GPEK) GPEK është projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i bashkëfinancuar nga Suedia dhe i zbatuar nga Helvetas.



DIKUR TRUPI I PAPËRSOSUR NA BËNTE TË NDIHESHIM TË PASIGURT - ME IA-në TANI EDHE MENDJA

Për pjesën më të madhe të historisë moderne, teknologjia është përpjekur të imitojë njerëzit. Njerëzit po përpiqen gjithnjë e më shumë të imitojnë teknologjinë.



Nga: Joseph de WECK
The Guardian (titulli: It used to be our imperfect bodies that made us insecure. With AI, it's our minds as well)

Dy fytyra që m'u shfaqën në Instagram gjatë muajve të fundit, më vunë në dyshim. Njëra i përkiste John Travoltas në Kanë. Tjetra, Carla Brunit gjatë një mbrëmjeje me bashkëshortin e saj, ish-presidentin francez Nicolas Sarkozy. Të dy dukeshin goxha si vetvetja, e megjithatë, të dy dukeshin edhe çuditërisht të panjohur. Pamja e tyre nxiti spekulime për trajtime kozmetike, ndonëse vetë ata nuk i kanë pranuar kurrë ato. Bruni më parë ka mohuar se e ka bërë atë punë. Sidoqoftë, ndjesia zgjati vetëm një sekondë: një çast paretie, sikur po shikoja njerëz që ishin bërë përafërime të vetvetes. Ka një emër për atë ndjesi. Në një artikull të vitit 1970, profesori japonez i robotikës, Masahiro Mori, përshkroi atë që e quajti "lulina e mistershme". Ai zbuloi se robotët që ishin projektuar për t'u dukur sa më njerëzorë, shpesh shkaktonin paretie te njerëzit. Kjo ishte befasuese, pasi përparësia e robotëve humanoidë supozohej të ishte se ne, njerëzit, do t'u besonim më shumë. Çfarë na frikëson te një robot që pothuajse kalon për njeri? Një shpjegim mund të jetë se ndiejmë rrezik kur ndeshemi

me diçka që nuk mund ta kategorizojmë lehtësisht as si njerëzore, as si jonjerëzore. Një shpjegim tjetër është se tiparet që duken "të çuditshme", si lëkura e shkëlqyeshme ose shprehjet e ngrira, u ngajnë shenjave të sëmundjes ose të vdekjes. Për një robot humanoid, shkaktimi i ndjesisë së luginës së mistershme do të thotë dështim. Por, çfarë nënkupton kur atë e shkakton një njeri? Në vitin 1956, filozofi gjermano-austriak, Günther Anders, botoi një përmbledhje esesh me titull The Obsolescence of the Human [Vjetrimi i njeriut]. Andersi, bashkëshorti i parë i Hannah Arendtit, argumentonte se përparimi teknologjik do t'i shtynte njerëzit të zhvillonin një formë të re të vetëpërcëimit. Të përballur me përsosmërinë e mallrave të prodhuara në masë, njerëzit do të arrinin të pendoheshin për "ngathtësinë e tyre trupore" dhe "pasaktësinë fizike". Ata do të turpëroheshin gjithnjë e më shumë që ishin thjesht rezultat i "procesit të verbër dhe të pallogaritshëm, tejet arkaik, të riprodhimit", në vend që të ishin rezultat i një projektimi të kujdesshëm.

Andersi shkroi:

Çdo ditë nga makinat dalin makina gjithnjë e më të bukura. Vetëm ne mbetemi të keqformuar, vetëm ne lindim të vjetruar. Por, këtu qëndron thelbi: Andersi parashikoi se njerëzit e

frikësuar nuk do ta gjenin forcën për t'u rebeluar kundër objekteve prej të cilave ndihen të poshtëruar. Përkundrazi, ata do të aspironin t'u ngjanin atyre. Do të donin të bëheshin më pak si njerëz dhe më shumë si një produkt: diçka e standardizuar, e optimizuar dhe, po, fjalë për fjalë, "e montuar". Pyes veten nëse kemi arritur të jetojmë në distopinë e Andersit. Me rënien e çmimeve, ka një lulëzim të procedurave kirurgjikale kozmetike si në mbarë globin, ashtu edhe në të gjitha grupet demografike. Dhe, shpesh qëllimi nuk duket se është të "korrigjohen" gabimet e natyrës apo të dukesh natyrshëm - vetëm pak më mirë, duke përvetësuar logjikën e projektimit të produktit, si simetria ose dallueshmëria. Këtë e ofrojnë fytyrat e konturuara dhe buzët me botoks që lidhen me Kim Kardashianin, ose mjekrat me kënde të theksuara që kërkojnë influencerët maskulinë [looksmaxxers]. Por, Andersi ka rëndësi sot për një arsye tjetër përveçse për të kuptuar idealet bashkëkohore të bukurisë. Kompleksi i inferioritetit të njeriut ndaj produkteve që sjellin fitim, të cilin ai e përshkroi, mund të mos kufizohet më vetëm te trupat tanë. Në epokën e IA-së [inteligjenca artificiale], ai po përhapet edhe në mendje. Sigurisht që mund ta ndiej turpin që përshkroi Andersi kur e krahasoj trurin tim të vogël, të

paqëndrueshëm në disponim dhe të ndjeshëm ndaj nxehtësisë me fuqinë e pandalshme dhe gjithmonë të qasshme llogaritëse të IA-së. Nuk është çudi, pra, që katër vjet pas lansimit publik të ChatGPT-së, përdorimi i IA-së po zgjerohet vazhdimisht - ashtu si procedurat kozmetike. Është një rreth vicioz: sa më e mirë të bëhet IA-ja dhe sa më e aftë të bëhet në imitim e njerëzve, vetëm pa të metat tona, aq më shumë do t'i perceptojmë mendjet tona si të mangëta. Dhe, aq më shumë do të tundohemi jo vetëm ta përdorim IA-në, por edhe të flasin, të këndojmë dhe të sillemi si teknologjia, në përpjekje për t'u ngjarë shpikjeve tona që nuk dështojnë. Ky është motori vetëpërforsues i vetëvetërsimit njerëzor në një epokë të përsosmërisë teknologjike. Një studim i vitit 2025 nga Instituti i mirënjohur gjerman Max Planck për Zhvillimin Njerëzor, i cili vlerësoi 360 mijë video në YouTube dhe 772 mijë podkaste, zbuloi se pas lansimit të ChatGPT-së, njerëzit filluan t'i përdornin shumë më shpesh fjalët e parapëlqyera nga çetboti i IA-së, si delve [gjurmim!], boast [mburrje!] dhe meticulous [pedanteri!] - madje edhe në gjuhën e tyre të folur. Kështu, nuk është më vetëm fytyra e ribërë përmes një procedure kozmetike. Është mesazhi me tekst nga personi me të cilin ke dalë në takim, që

tingëllon çuditërisht stakato. Balada e butë e dashurisë që e ke dëgjuar pa pushim për një javë, derisa kupton se është krijuar nga një program që nuk ka përjetuar kurrë një ndarje të dhimbshme. Ish-kolegu yt i punës, i cili dikur u përgjigjej letrave elektronike me nga një rresht dhe tani boton tri ese fine në javë në Substack. Ndjesia e luginës së mistershme shfaqet kudo ku fillojmë të dyshojmë në natyrën njerëzore të asaj që qëndron përpara nesh. Ai dyshim, ajo ndjesi e çuditshme nëse ajo që shohim, lexojmë dhe dëgjojmë është vërtet njerëzore apo jo, tani na shoqëron kudo. Ai dyshim i vazhdueshëm ndoshta po bëhet gjendja përcaktuese e jetës sonë ndërsa hyjmë në çerekun e dytë të shekullit XXI. Teknologjia arrin të na imitojë në mënyrë gjithnjë e më bindëse dhe ne, njerëzit, nuk mund t'i rezistojmë prirjes për t'u përafëruar shpikjeve tona të lavdishme teknologjike. Teksa si njerëzit ashtu edhe teknologjia zhvendosen në të njëjtën hapësirë hibride gri, lugina e mistershme është tani hapësira ku banojmë. Megjithatë, nuk duhet të përpiqemi ta eliminojmë atë ndjesi të vazhdueshme paretie. Përkundrazi, duhet të mësojmë ta kultivojmë. Ka shpresë për sa kohë që diçka brenda nesh, ndoshta druri i shtrembër i natyrës sonë njerëzore, zmbrahet nga ajo botë. Të njohim vetëvetërsimin tonë do të thotë të fillojmë t'i rezistojmë atij. /Telegrafi/

KUSH E KONTROLLON VËRTET DETIN KASPIK?



Asnjëri nga pesë shtetet në brigjet e Detit Kaspik nuk zotëron ndonjë pjesë fikse të tij. Një konventë e vitit 2018 përcaktoi rregullat e lundrimit, sigurisë dhe peshkimit. Kufijtë e shtratis detar nuk janë zgjidhur. Për dekada me radhë, debati në Iran për Detin Kaspik është përqendruar shpesh rreth një pyetjeje në dukje të thjeshtë: Sa për qind e Detit Kaspik i takon Iranit?

Irani,Rusia, Azerbajxhani, Kazakistani dhe Turkmenistani kanë të gjithë dalje në këtë masë ujore. Megjithatë, Kaspiku nuk trajtohet as si një det i zakonshëm dhe as thjesht si një liqen ndërkombëtar. Në vend të kësaj, këto pesë vende kanë zhvilluar një regjim të veçantë juridik që rregullon lundrimin, ujërat territoriale, peshkimin, sigurinë dhe burimet nëujore.

Hapi më i rëndësishëm u bë në vitin 2018, kur presidentët e pesë vendeve nënshkruan Konventën për Statusin Ligjor të Detit Kaspik në Aktau të Kazakistanit. Konventa përcaktoi ujëra territoriale deri në 15 milje detare dhe një zonë ekskluzive peshkimi prej 10 miljesh detare shtesë për secilin shtet. Megjithatë, ajo nuk e ndau të gjithë Kaspikun në pesë pjesë fikse kombëtare.

Pse Irani nuk zotëron gjysmën e Detit Kaspik?

Para shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik në vitin 1991, Irani dhe Bashkimi Sovjetik ishin të vetmet vende që kufizoheshin me Detin Kaspik. Traktati i Miqësisë Ruso-Persian i vitit 1921 riktheu të drejtat e

lundrimit të Iranit, të kufizuara më parë nga Rusia Perandorake. Një traktat i vitit 1940 rregulloi më tej tregtinë dhe lundrimin. Megjithatë, asnjëri prej këtyre traktateve nuk i jepte Iranit 50% të Detit Kaspik. Ahmad Vakhshiteh, drejtor i Qendrës për Kërkime Strategjike mbi Zhvillimin e Marrëdhënieve me Lindjen e Mesme në Moskë, thotë se ky dallim është thelbësor për të kuptuar mosmarrëveshjen.

"Asnjë prej këtyre traktateve nuk përcaktonte një përqindje për Iranin apo Bashkimin Sovjetik. Ato theksonin përdorimin e përbashkët dhe jo ndarjen e detit në pjesë pronësie."

Pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, Azerbajxhani, Kazakistani dhe Turkmenistani u bënë shtete të pavarura, duke e shndërruar një marrëveshje dypalëshe në një negociatë mes pesë vendeve.

Disa politikanë iranianë kërkuan një pjesëmarrje prej 50%, duke argumentuar se më parë Irani e kishte ndarë detin vetëm me Bashkimin Sovjetik. Të tjerë propozuan 20%. Deri më sot, asnjë prej këtyre pretendimeve nuk ka marrë njohje ndërkombëtare.

Çfarë zgjidhi marrëveshja e vitit 2018?

"Deti Kaspik nuk është as plotësisht det dhe as plotësisht liqen", tha Vakhshiteh.

Sipas tij, Konventa e vitit 2018 krijoi një regjim të veçantë juridik që bën dallimin midis ujit, shtratis detar, sigurisë dhe burimeve natyrore.

Konventa nuk e ndan sipërfaqen e ujit në sektorë kombëtarë. Çdo

shtet ka ujërat e veta territoriale dhe zonat e peshkimit, ndërsa pjesët e tjera mbeten të hapura për lundrim të përbashkët. Shtrati detar mund të ndahet përmes marrëveshjeve ndërmjet vendeve fqinje. Këto marrëveshje janë veçanërisht të rëndësishme sepse të drejtat mbi naftën dhe gazin në det varen kryesisht nga këta kufij.

Rusia,Kazakistani dhe Azerbajxhani kanë arritur tashmë disa marrëveshje dypalëshe për delimitimin. Kufijtë jugorë të Iranit mbeten ndër çështjet më të ndjeshme politikisht.

Si u bë siguria një çështje qendrore?

Konventa e vitit 2018 ndalon praninë e forcave të armatosura të shteteve që nuk kufizohen me Detin Kaspik. Gjithashtu, vendet bregdetare nuk duhet të lejojnë përdorimin e territorit të tyre për veprime ushtarake kundër një shteti tjetër kaspik.

Megjithatë, së fundmi Irani akuzoi Ukrainën për sulmin ndaj një anijeje tregtare iraniane në Detin Kaspik, ku humbi jetën një marinar. Kiev deklaroi se kishte shënjestruar mjete lundruese të përfshira në transportin e ngarkesave ushtarake të lidhura me Iranin dhe Rusinë.

Vakhshiteh argumenton se incidente të tilla tregojnë pse Teherani e konsideron largimin e fuqive ushtarake të jashtme nga Kaspiku si një prioritet strategjik.

"Irani mund të vazhdojë të negociojë për kufijtë e shtratis detar, por një parim i rëndësishëm tashmë ekziston: Deti Kaspik nuk duhet të kthehet në një bazë ushtarake për fuqitë

jashtë rajonit."

Aktualisht, Irani është i vetmi nga pesë nënshkruesit që nuk e ka ratifikuar ende plotësisht konventën në parlament.

Nafta dhe gazi në Detin Kaspik

Pas debateve juridike dhe ushtarake fshihet një çështje tjetër madhore: energjia.

Azerbajxhanidhe Kazakistani kanë zhvilluar burime të konsiderueshme të naftës në det të hapur, ndërsa Turkmenistani zotëron rezerva të mëdha gazi natyror.

Strategu i energjisë Umud Shokri thotë, se edhe Irani ka potencial të rëndësishëm hidrokarburësh.

Zbulimi më i rëndësishëm iranian në Kaspik, Sardar-e Jangal, u bë në vitin 2012, por zhvillimi i tij ka qenë i ngadaltë dhe ende nuk ka hyrë në prodhim komercial.

Vlerësimet iraniane sugjerojnë se zona mund të përmbajë rreth 2 miliardë fuçi naftë, nga të cilat afërsisht 500 milionë mund të nxirren teknikisht, si dhe rezerva gazi natyror.

"Irani ka zbulime të konfirmuara hidrokarburesh dhe perspektiva premtuese, por baza e tij e burimeve komercialisht të shfrytëzueshme në Kaspik mbetet e pasigurt dhe kryesisht e pazhvilluar", tha Shokri.

Pjesa jugore e Detit Kaspik është dukshëm më e thellë se zonat e zhvilluara nga fqinjët e Iranit. Fusha Sardar-e Jangal ndodhet në ujëra rreth 700 metra të thella, gjë që kërkon pajisje moderne shpimi, teknologji nënujore dhe investime të mëdha.

Sanksionet ndërkombëtare e kanë bërë më të vështirë aksesin

e Iranit në teknologji, financim dhe kompani të specializuara.

Përveç kësaj, Irani ka alternativa më të lehta. "Irani ka fusha shumë të mëdha nafte dhe gazi në Gjirin Persik dhe në tokë, të cilat zakonisht janë më të lehta dhe më të lira për t'u zhvilluar", tha Shokri.

Për këtë arsye, investimi i miliarda dollarëve në projekte të vështira në ujërat e thella të Kaspikut ka qenë shpesh më pak tërheqës sesa zgjerimi i prodhimit në Gjirin Persik, si në fushën e gazit South Pars.

Pra, kush e zotëron Detin Kaspik?


Në fund, asnjë vend nuk e zotëron ose kontrollon i vetëm Detin Kaspik. Asnjë traktat nuk i jep Iranit, Rusisë apo ndonjë shteti tjetër një pjesë fikse të kësaj mase ujore.

Pesë shtetet bregdetare kanë ujëra territoriale dhe zona ekskluzive peshkimi, ndërsa pjesët e tjera mbeten të hapura për përdorim të përbashkët.

Kufijtë e shtratis detar, të cilët përcaktojnë shumë nga të drejtat për naftën dhe gazin në det, negocohen veçmas ndërmjet vendeve fqinje. Për Iranin, kjo do të thotë se disa nga të drejtat e tij mbi burimet në det të hapur mbeten ende objekt negociatash.

Megjithatë, sot pyetja mbi përqindjen e pronësisë nuk është më çështja kryesore.

Sfidat më të rëndësishme janë menaxhimi i burimeve të Detit Kaspik, përcaktimi i kufijve detarë dhe ruajtja e rajonit nga prania e forcave ushtarake të jashtme. (DW)



U. d. presidentja Haxhiu në Taranto për hapjen e Lojërave Mesdhetare “Taranto 2026”

Prishtinë, 20 gusht - Ushtruesja e detyrës e presidentes së Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka udhëtuar të enjten për në Itali, ku do të marrë pjesë në hapjen e Lojërave Mesdhetare “Taranto

2026”.

U. d. presidentja Haxhiu do të marrë pjesë edhe në pritjen që presidenti i Italisë, Sergio Mattarella, organizon për krerët e shteteve dhe përfaqësuesit e lartë të

vendeve pjesëmarrëse në Lojëra.

Në këto Lojëra, Kosova merr pjesë në 17 sporte individuale dhe në katër sporte ekipore, me gjithsej 163 sportistë, numri më i madh me të cilin është

përfaqësuar deri më tash në Lojërat Mesdhetare.

Edicioni i Tarantos ka rëndësi të veçantë për Kosovën edhe për faktin se edicioni i ardhshëm i Lojërave Mesdhetare do të mbahet në Prishtinë më 2030.



PARAQITET PËRPARIMI PËR LOJËRAT MESDHEHETARE PRISHTINA 2030 NË ASAMBLENË E ICMG-së

PRISHTINË, 20 GUSHT - Në Taranto të Italisë po mbahet Asambleja e Përgjithshme e Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare (ICMG), ku një pjesë e punimeve u është kushtuar edhe përgatitjeve për Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030. Gjatë Asamblesë, krahas zgjedhjes së presidentit dhe

organeve të reja drejtuese të ICMG-së, do të paraqitet edhe përparimi i bërë deri më tani për organizimin e Lojërave Mesdhetare në Prishtinë nga ministri për Sport dhe Rini, Blerim Gashani.

Në punimet e Asamblesë po marrin pjesë edhe drejtuesit e Komitetit Olimpik të

Kosovës (KOK), përfshirë presidentin Ismet Krasniqi, sekretarin e përgjithshëm Besim Aliti dhe nënpresidentin Milaim Kelmendi.

Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030 përbëjnë një nga ngjarjet më të rëndësishme sportive ndërkombëtare që do të organizohen në Kosovë.



SOT NIS SEZONI I RI NË SUPERIORE, DREJTORI I GARAVE: FORMAT I RI, GARË DINAMIKE DHE MË SHUMË EMOCIONE

TIRANË, 20 GUSHT - Sezoni i ri i “Abissnet Superiore” do të nisë sot (e premte) me ndeshjen Vllaznia - Skënderbeu që do ta çelë zyrtarisht kampionatin të premten, në orën 21:00, në stadiumin “Loro Boriçi”. Në prag të startit të sezonit 2026/27, drejtori i Garave në Federatën Shqiptare të Futbollit, Marjus Sulejmani, ka folur për risitë e kampionatit, formatin e ri të garës dhe pritshmëritë për sezonin e ri. Sulejmani ka bërë me dije se ceremonia tradicionale e hapjes do të zhvillohet te kampionët në fuqi, Egnatia, në ndeshjen ndaj Tiranës. “Kampionati nis ditën e premte. Ndeshja e parë që do të zhvillohet është Vllaznia - Skënderbeu, në orën 21:00. Gjithashtu ditën e shtunë do të luhen dy ndeshje dhe dy takimet e tjera do të zhvillohen ditën e diel. Si çdo vit,

ceremonia e hapjes organizohet tek ekipi kampion, ku këtë sezon është Egnatia dhe në ndeshjen Egnatia - Tirana, e planifikuar ditën e diel, do të bëhet ceremonia e hapjes së kampionatit”, ka thënë Sulejmani.

Drejtori i Garave ka shpjeguar edhe ndryshimet që sjell sezoni i ri, me një format të ri pas përfundimit të tri fazave të rregullta. “Risitë janë të shumta. Këtë sezon kemi ndryshim të formatit të garës, ku pas tri fazave të rregullta, ekipet do të ndahen në dy faza: ‘play-off’, ku do të garojnë gjashtë ekipet e para për shpalljen e ekipit kampion, dhe katër ekipet e tjera, që janë të renditura nga vendi i shtatë në vendin e dhjetë, do të marrin pjesë në fazën ‘play-out’”, ka deklaruar ai.

Sulejmani është ndalur edhe te



rregulli për aktivizimin e lojtarëve të rinj me pasaportë shqiptare. “Siç e dini, ekipet do të aktivizojnë lojtarë me pasaportë shqiptare të datëlindjes 2007 e në vijim. Në ‘Abissnet Superiore’ rregulli është i tillë që ekipet do të duhet ta nisin ndeshjen me një lojtar minimalisht të datëlindjes 2007, i cili do të duhet të aktivizohet një pjesë loje. Ndërsa sa iu përket kategorive të tjera, të parë, të dytë dhe të tretë, ky rregull është që ekipet do të duhet të aktivizojnë lojtarë të

datëlindjes 2007 me pasaportë shqiptare gjatë gjithë ndeshjes”, ka sqaruar Sulejmani.

Duke folur për strukturën e re, ai ka thënë se synimi është që kampionati të jetë sa më konkurrues dhe të sjellë më shumë spektakël për tifozët. “Struktura e kampionatit është e tillë. Skema është shumë dinamike. Urojmë që të kemi sa më shumë tifozë, sa më shumë spektakël, sa më shumë ‘fair-play’ në fushë dhe në tribuna”, ka thënë drejtori i Garave.

Sulejmani ka folur edhe për paraqitjen e skuadrave shqiptare në garat evropiane, duke i uruar suksese Egnatias dhe Dinamo Cityt në sfidat e ardhshme. “Këtë sezon kemi një përfaqësim shumë dinjitoz të Egnatias, që ka siguruar tashmë fazën e ligës në UEFA Conference League, por është

akoma në garë për të marrë pjesë në Europa League, ku ndeshja e parë do të luhet më 20 gusht dhe takimi i kthimit më 27 gusht”, ka deklaruar ai. Sa i përket Dinamo Cityt, Sulejmani ka bërë me dije se skuadra shqiptare do të përballlet me Pafos në “play-off”. “Gjithashtu, Dinamo City më 20 gusht ka ndeshjen e parë të play-off-it ndaj Pafos, që do të zhvillohet në ‘Elbasan Arena’, ndërsa ndeshja e kthimit më 27 gusht. Urojmë që të dyja ekipet, si Egnatia ashtu edhe Dinamo City, të kualifikohen. Egnatia tashmë e ka siguruar fazën e ligës në Conference League, ndaj urojmë që të shkojë në Europa League. Gjithashtu, shumë suksese Dinamos që në ndeshjen e ‘play-off’-it të kualifikohet në fazën e ligës së Conference League”, ka përfunduar Sulejmani.

Chelsea sërish pa sponsor në fanellë, zbulohet arsyeja e pazakontë

LONDËR, 20 GUSHT - Chelsea po përgatitet të nisë edhe një sezon tjetër pa sponsor në pjesën e përparme të fanellës, duke e bërë këtë për të tretin vit radhazi. Ish-drejtuesi i aktiviteteve globale të marketingut te Chelsea, Christian Purslow, ka folur për këtë situatë të pazakontë, duke theksuar se problemi nuk qëndron te

mungesa e kompanive të interesuara për të bashkëpunuar me klubin londinez. “Është intriguese dhe, të jem plotësisht i sinqertë, e pabesueshme që Chelsea po nis një tjetër sezon pa sponsor kryesor në fanellë”, deklaroi Purslow. Sipas tij, arsyeja lidhet me qëndrimin e pronarëve të klubit, të cilët nuk dëshirojnë të pranojnë një marrëveshje që,

sipas tyre, nuk e pasqyron vlerën reale të hapësirës reklamuese në fanellën e Chelseat. “Jo sepse nuk ka marka që duan të jenë në fanellën e Chelseat, por sepse kjo pronësi ka një qëndrim të çuditshëm. Ata pëlqejnë të mos kenë fare sponsorë sesa të pranojnë një shumë që mendojnë se nuk e pasqyron vlerën e vërtetë të fanellës”,

shtoi Purslow.

Chelsea nuk do të ketë, kështu, një sponsor në pjesën e përparme të fanellës edhe gjatë këtij sezoni. Megjithatë, klubi mbetet i hapur për një marrëveshje gjatë sezonit, nëse paraqitet një ofertë që përputhet me vlerësimin financiar të drejtuesve. Situata është bërë veçanërisht e pazakontë për një klub të



përmasave të Chelseat, duke pasur parasysh vlerën e madhe komerciale që zakonisht kanë hapësirat reklamuese në fanellat e skuadrave elitare.



RI-SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita: Mbikëqyrës/e i/e Lartë Bankar
Niveli i gradës: P05
Kohëzgjatja e punësimit: me afat të pacaktuar
Departamenti: Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare
Divizioni: Divizioni për Mbikëqyrjen në Vend të Bankave
I raporton: Udhëheqësit të Divizionit për Mbikëqyrjen në Vend të Bankave

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Kryen ekzaminimet në vend dhe shqyrton raportet e bankave;
- Udhëheqë ekipin e ekzaminerëve në ekzaminimet në vend në banka;
- Planifikon, koordinon dhe udhëheqë resurset dhe kohën e nevojshme për ekzaminimet në vend në banka;
- Përcakton fushëveprimin e ekzaminimeve në vend dhe identifikon masat detyruese pas ekzaminimit, ndaj bankave;
- Përpilon raportet e ekzaminimit dhe vlerëson përshtatshmërinë e draft raporteve të përgatitura nga ekzaminierët bankar për fushat e tyre të përgjegjësisë, në ekzaminimet në vend në banka;
- Përgatitë strategjitë mbikëqyrëse konform profilin të rrezikut të bankave dhe i rekomandon mbikëqyrësit shpeshtësinë dhe fushëveprimin e ekzaminimeve në vend;
- Identifikon rreziqet dhe veprimet detyruese si dhe rekomandon përshtatjen e strategjive mbikëqyrëse të bankave;
- Monitoron performancën financiare, zbatimin e rekomandimeve, kërkesat nga ekzaminimet në vend, si dhe zbatimin e masave detyruese të shqiptuara ndaj bankave;
- Udhëzon dhe bartë njohuritë tek mbikëqyrësit bankar dhe mbikëqyrësit e ri bankar;
- Ndihmon në përpilimin e politikave, rregulloreve, udhëzimeve, si dhe procedurave të brendshme tjera të punës;
- Detyra tjera të caktuara nga mbikëqyrësi në kudër të përgjegjësi të Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare.

Njohuritë akademike dhe profesionale të kërkuara:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, drejtësisë, shkencave kompjuterike, teknike, matematikës apo në fusha të tjera që lidhen me përgjegjësitë e njësive organizative, sipas përshkrimit të publikuar në uebfaqen e BQK-së;
- Preferohet të posedojë diplomë ose certifikatë profesionale ekuivalente me nivelin e kontabilistit të certifikuar dhe/ose auditorit të certifikuar.

Përvoja profesionale e kërkuar:

- Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale në sektorin financiar ose në fushën që lidhet me përgjegjësitë e njësive organizative, sipas përshkrimit të publikuar në uebfaqen e BQK-së;

Aftësitë dhe njohuritë teknike:

- Njohja e mirë e Ms. Office.
- Njohja e gjuhës angleze përparësi.

Kërkesat e posaçme:

- Njohuri të shquara analitike, të nevojshme për analiza financiare, si dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e menaxhimit të rreziqeve bankare në banka;
- Njohuri të shquara të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF), me qëllim të identifikimit dhe verifikimit të përshtatshmërisë së transaksioneve në regjistrimet kontabël të bankave;
- Njohuri të shquara për kuadrin ligjor, rregulloret dhe standardet aplikative të zbatueshme ndaj bankave për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre;
- Kërkohet përpikëri në respektimin e afateve për punët dhe angazhimet e caktuara nga mbikëqyrësi;
- Kërkohen aftësi të shquara për vlerësime dhe vendimmarrje të pavarur nga mbikëqyrësit;
- Kërkohet të demonstroj aftësi të shquara të komunikimit gojor, komunikimit me shkrim, të dëgjimit dhe prezantimit tek mbikëqyrësi, ekipi i ekzaminimit dhe palët tjera;
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive në ekip; aftësi në menaxhimin e kohës lidhur me kompletimin dhe cilësinë e detyrave të punës; aftësi për të punuar në mënyrë efektive me mbikëqyrësin dhe ekipin; aftësi të punuarit, diskutimit dhe bindjes me palët e jashtme;

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të **Formularit zyrtar të BQK-së gjatë aplikimit online** nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes.
- Kandidatët duhet të **bashkëngjisin letër përcjellëse (motivuese)**, e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur **posaçërisht për pozitën për të cilën aplikojnë**; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim;
- Dëshmi mbi përvojën e punës, që mbulojnë paku tre (3) vite përvojë pune** (kopje të kontratave të punës, vërtetime nga punëdhënësi apo dokumente të tjera relevante që dëshmojnë pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse, që mbulon paku tre (3) vite përvojë pune**, ose, në rastet kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht, vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **07 shtator 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.



PONOVLJENI OGLAS O SLOBODNOM RADNOM MESTU

Pozicija: Viši bankarski supervizor
Nivo ranga: P05
Trajanje zapošljavanja: na neodređeni rok
Odeljenje: Odeljenje za bankarski nadzor
Odsek: Odsek za nadzor banaka u Zemlji
Izveštava: Rukovodiocu Odseka o nadzoru banaka u Zemlji

Sažetak dužnosti i odgovornosti:

- Sprovodi ispitivanja u zemlji i razmatra izveštaje banaka;
- Rukovodi timom ispitivača u ispitivanjima banaka u mestu;
- Planira, koordinira i rukovodi resursima i vreme potrebno za ispitivanja banaka u zemlji;
- Utvrdjuje delokrug ispitivanja u zemlji i utvrđuje obavezne mere nakon ispitivanja, prema bankama;
- Sastavlja izveštaje o ispitivanju i procenjuje podobnost nacрта izveštaja koje pripremaju ispitivači banaka za svoje oblasti nadležnosti, u ispitivanja banaka u zemlji;
- Priprema supervizorske strategije u skladu sa profilom rizika banaka i preporučuje supervizoru učestalost i delokrug ispitivanja u zemlji;
- Identifikuje rizike i mere sprovođenja i preporučuje prilagođavanje nadzorskih strategija banaka;
- Prati finansijske rezultate, sprovođenje preporuka, zahteve iz ispitivanja u zemlji, kao i sprovođenje obavezujućih mera nametnutih bankama;
- Upućuje i prenosi znanje bankarskim supervizorima i novim bankarskim supervizorima;
- Pomaže u izradi politika, propisa, smernica, kao i drugih unutrašnjih radnih procedura;
- Ostali poslovi koje dodeljuje supervizor u okviru nadležnosti Odeljenja za nadzor banaka.

Potrebno akademsko i profesionalno znanje:

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, prava, računarskih, tehničkih nauka, matematike ili iz drugih oblasti vezanih za nadležnosti organizacionih jedinica, prema opisu objavljenom na internet stranici CBK-a;
- Poželjno je da poseduje profesionalnu diplomu ili sertifikat ekvivalentan nivou ovlašćenog računovođe i/ili sertifikovanog revizora.

Potrebno profesionalno iskustvo:

- Imati najmanje tri (3) godine radnog iskustva u finansijskom sektoru ili u oblasti koja se odnosi na nadležnosti organizacione jedinice, prema opisu objavljenom na internet stranici CBK-a;

Tehničke sposobnosti i znanja:

- Dobro poznavanje Ms. Office.
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.

Posebni zahtevi:

- Izvanredno analitička znanja, neophodna za finansijsku analizu, kao i za procenu adekvatnosti upravljanja bankarskim rizicima u bankama;
- Izvanredno poznavanje Međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja (MSFI), u cilju identifikacije i verifikacije adekvatnosti transakcija u računovodstvenim registrima banaka;
- Izvanredno poznavanje zakonskog okvira, propisa i standarda primene koji se primenjuju na banke za procenu njihove usklađenosti;
- Potrebna je pedantnost u poštovanju rokova za poslove i obaveza koje je odredio supervizor;
- Potrebne su sposobnostiza nezavisne procene i donošenje odluka od strane supervizora;
- Potrebno je pokazati izvanrednu usmenu komunikaciju, pisanu komunikaciju, slušanja, i prezentacija veštine supervizora, ispitni tim, i druge strane;
- Sposobnost efikasnog rada u timu; sposobnosti upravljanja vremenom vezane za završetak i kvalitet radnih dužnosti; sposobnost efikasnog rada sa supervizorom i timom; sposobnost rada, diskusije i ubeđivanja spoljnih strana;

Svi kandidati moraju poslati sledeće dokumente:

- Prijave sa potpunim i ispravnim popunjavanjem **Službenog obrasca CBK-a tokom online prijave** neće biti razmatrane i rezultirati diskvalifikacijom tokom procesa izbora.
- Kandidati moraju **priložiti propratno pismo (motivaciono)**, koje mora biti adresirano i pripremljeno **posebno za poziciju za koju se prijavljuju**; u suprotnom, prijava neće biti uzeta u razmatranje;
- Dokaz o radnom iskustvu, koji pokriva najmanje tri (3) godine radnog iskustva** (kopije ugovora o radu, potvrde od poslodavca ili drugi relevantni dokumenti koji dokazuju radno mesto i radno iskustvo, bez kršenja relevantnih akata za zaštitu ličnih podataka).
- Izveštaj Kosovskog penzionog štednog fonda (Trust) za relevantni period, koji obuhvata najmanje tri (3) godine radnog iskustva**, ili, u slučajevima kada izveštaj Fonda nije zakonski primenljiv, poresku potvrdu Poreske administracije Kosova (PAK);
- Kopije diploma, dok diplome stečene izvan Republike Kosovo moraju biti službeno priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak prijave:

- Krajni rok za prijavu je **07. septembar 2026**.
- Prijava se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko službene internet stranice CBK-a. Ostali obrasci za prijavu neće se uzeti u obzir.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Endri Brovina shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 6 të "Loyola Gynasium" Prizrem.

- Trim Reznici shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Sebastjan Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u "Ahmet Rustemi" Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik "Fehmi Agani" Gjakovë, drejtimi Infermier, Bachelor me nr. 104.

- Atdhe Gashi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën si dhe certifikatën e diplomës të shkollës së mesme Teknike "28 Nëntori" Prishtinë.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti" në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë "Dr. Xheladin Deda".

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m."Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

